REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës:	2019:123513
Datë:	14.02.2023
Numri i dokumentit:	03977873

C.nr.413/18

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtare Njomëza Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale D.A. në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosova e Sigurimit (BKS), me seli në Prishtinë, rr. "....." Prishtinë-Fushë Kosovë, p.nr., të cilën me autorizim e përfaqëson V.N. nga Prishtina, kundër të padituri G.(I) S. nga Prizreni, rr. "....." për shkak të rimbursimit të dëmit, vlera e kontestit 553.00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, në prezencë të përfaqësuesit të autorizuar të paditëses dhe palës paditur, më datë 01.02.2023, mori këtë:

A K T GJ Y K I M

I. **APROVOHET** kërkesëpadia e paditëses B.K.S. me seli në Prishtinë, **në tërësi si e bazuar**.

II. **DETYROHET** i padituri G. (I) S. nga Prizreni, që në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit, të datës 30.03.2015 në Prizren, t'i paguaj paditëses shumën **prej 553.00 (pesëqind e pesëdhjetë e tre) Euro**, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë (datë 23.03.2018), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

III. **OBLIGOHET** i padituri që paditëses t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 20.00 (njëzetë) Euro në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësja B.K.S. me seli në Prishtinë, më datë 23.03.2019, në Gjykatën Themelore në Prizren, ka paraqitur padi kundër të padituri G. (I) S. nga Prizreni, për shkak të rimbursimit të dëmit, duke theksuar se i padituri me datë 30.03.2015 rreth orës 16:50 minuta në Prizren, ka shkaktuar aksident trafiku me automjetin Esoace Renault, me targa të regjistrimit .... dhe deri tek aksidenti ka ardhur kur automjeti "A" të cilin e drejtonte G. (I) S. i cili nga pakujdesia i shkakton dëme të dëmtuarit K.D. Gjithashtu ka theksuar se automjeti i cili ka qenë shkaktar i aksidentit në

2019:123514

fjalë në momentin e shkaktimit të aksidentit ka qenë pa mbulesë siguruese, konkretisht me afat të skaduar të policës siguruese. Si rezultat i këtij aksidenti paditësja B.K.S. në respektim të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia Nr.04L-018 dhe në respektim të dispozitave të LMD-së, i'a ka kompensuar dëmin e shkaktuar të dëmtuarit Kushtrim Doda.

I autorizuari i paditëses edhe për gjatë seancave gjyqësore ka ngelur pranë padisë dhe kërkesëpadisë duke i kundërshtuar pretendimet e palës së paditur në përgjigje në padi për faktin se padia është paraqitur në formë dhe në përmbajtje sipas kërkesave që dalin nga LPK, si dhe brenda afatit ligjor sipas LMD-së duke shtuar se BKS ka bërë kompensimin – regresin e pagesës së dëmit dhe sipas provave të paraqitura dhe ekspertizës së ekspertes së komunikacionit rrugor vërtetohet baza e kërkesëpadisë. Në fund i ka propozuar Gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta aprovojë në tërësi si të bazuar, ashtu që të obligohet i padituri që paditëses ti rimbursojë dëmin në shumën prej 553.00 (pesëqind e pesëdhjetë e tre) Euro me kamatë ligjore, në emër të dëmit të shkaktuar ne aksidentin e trafikut, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës gjyqësore konkretisht të taksës për padi në vlerë prej 20.00 (njëzetë) Euro në afat prej 15 (pesëdhjetë) ditësh nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

I padituri në përgjigjen në padi si dhe gjatë seancave gjyqësore i ka propozuar Gjykatës që padinë e paditësit ta refuzojë si të pa bazuar pasi që asnjëra nga faktet të cilat paditësi i kërkon nuk qëndrojnë. Përveç tjerash provat që paditësi është munduar t'i paraqesë në letër i konsideroj të papranueshme duke filluar nga Raporti i Policisë të cilin paditësi e përdor në rastin konkret e deri te ujdia gjyqësore që është bërë në mes paditësit dhe palës së dëmtuar. Nga ana tjetër ka theksuar se padia e paditëses si e tillë nuk mund të qëndrojë sepse e njëjta nuk i plotëson kushtet ligjore në kuptim të nenin 102 të LPS-së si për nga baza, nga provat e po ashtu edhe nga afati.

Në seancat e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare i padituri ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar për faktin se e njejta nuk është e bazuar në prova dhe fakte nga të cilat do të dilte bazueshmëria e saj, andaj i ka propozuar gjykatës refuzimin e saj.

Provat e administruara

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka bërë administrimin e provave dhe atë: leximin e Ekspertizës së komunikacionit të datës 14.04.2022 të Ing.E.S. nga Prizreni si dhe dëgjimi i saj në seancën e shqyrtimit kryesor, leximi i Raportit policor të aksidentit me numër 215-GA-0777 datë 30.03.2015, leximi i Konfirmimit të policës siguruese, leximi i Ujdisë jashtëgjyqësore e datës 22.06.2015 si dhe leximi i Urdhër transferit bankar i datës 01.07.2015.

Gjykata pas vlerësimit të theksimeve të palëve dhe provave të administruara në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit **është tërësisht e bazuar**.

Faktet

Nga leximi i Ekspertizës së komunikacionit të datës 14.04.2022 gjykata ka vërtetuar se aksidenti në komunikacion ka ndodhur me datën 30.03.2015 rreth orës 16:50 minuta në rr. "William Walker" në drejtim që qendrës së qytetit, saktësisht përballë tregut "Fatoni" në Prizren. Duke u bazuar në përfundimet e nxjerra nga kjo ekspertizë është vërtetuar fakti se deri tek ky

aksident ka ardhur nga lëshimet e bëra nga ana e ngasësit të kombit A "Renault Espase" ngjyrë e kuqe, me targa të regjistrimit .... të cilin e drejtonte G. (I) S. këtu paditësi, i cili gjatë lëvizjes – gjatë kyçjes në rrugën kryesore nga pakujdesia goditet në pjesën e prapme të këndit të majtë me pjesën e përparme të automjetit B , i cili po ashtu ishte duke lëvizur në drejtim të qendrës së qytetit. Pra, automjeti "A" gjatë kyçjes nga një depo mielli nuk është kujdesur për pozitën e mjetit duke pasur parasysh që po kyçej në rrugë kryesore dhe nënkupton që duhet t'i jepte përparësi çdo mjeti apo pjesëmarrësi tjetër që ishte duke lëvizur në atë pjesë të rrugës. Si pasojë e kësaj goditje është shkaktuar ky aksident tek i cili ka pasur dëme materiale. Ekspertja e komunikacionit ing.E.S. nga Prizreni, është dëgjuar në seancën e shqyrtimit kryesor, ku e njejta ka deklaruar se mbetet si në ekspertizën e shkruar duke shtuar se në momentin e shkaktimit të aksidentit automjeti që e ka vozitur paditësi automjeti "A" ka qenë në kyqje e sipër ashtu me rastin e kyqjes nuk është kujdesur për pozitën e mjetit, duke pasur parasysh që po kyqej në rrugë kryesore, që nënkupton që duhej ti jepte përparësi çdo mjeti apo pjesëmarrësi tjetër që ishte duke lëvizur në atë pjesë të rrugës, ndërsa automjeti tjetër nuk ka kontribut në shkaktimin e këtij aksidenti.

Nga leximi i Raportit policor të aksidentit me numër 215-GA-0777 datë 30.03.2015, gjykata ka vërtetuar faktin se deri tek aksidenti ka ardhur si pasojë e veturës "A" Renault Espasse, pasi që vetura "B" VW-Passat ishte duke qarkulluar në drejtim të qytetit dhe me të arritur përballë Tregut "Fatoni", para një depo mielli dhe vetura "A" pa e siguruar kyçjen kishte ndërmarrë veprime të pa siguruara me automjet ku si pasoje e këtij veprimi është shkaktuar aksidenti me dëme materiale.

Nga leximi i Konfirmimit të policës siguruese, gjykata ka vërtetuar faktin se automjeti i cili kishte shkaktuar aksidentin e datës 30.03.2015 në momentin e shkaktimit të këtij aksidenti ka qenë pa mbulesë sigurie, respektivisht me afat të skaduar të polisës së sigurimit. Vetura "Renault Espasse" mbulesën e sigurisë e ka pasur valide nga data 20.02.2014 deri me datë 20.02.2015.

Nga leximi i Ujdisë jashtëgjyqësore e datës 22.06.2015, gjykata ka vërtetuar se është arritur marrëveshja jashtëgjyqësore ne mes të B.K.S. dhe të dëmtuarit K.D. nga Prizreni, përmes të autorizuarit E.Q. me të cilën ujdi janë rregulluar të gjitha çështjes që lidheshin me rastin e dëmit të pësuar në aksident trafiku me datë 30.03.2015 në Prizren, ku përgjegjës ishte i paditurit – shoferi G.S. ngasës i automjetit "Renault Espasse". Sipas kësaj marrëveshje në emër të dëmit material të dëmtuarit i është paguar shuma prej 553.00 (pesëqind e pesëdhjetë e tre) Euro.

Nga leximi i Urdhër transferit bankar i datës 01.07.2015, gjykata ka vërtetuar faktin se është bërë transferimi i shumës prej 553.00 Euro, në emër të kompensimit të dëmit nga këtu paditësja, tek përfaqësuesi i të dëmtuarit E.Q. për të dëmtuarin K.D.

Baza ligjore

Me nenin 18 par. 1 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia Ligji Nr.04/L-018, dëmshpërblimi nga përdorimi i mjetit të pasiguruar është paraparë se**:** *"Personit të dëmtuar të cilit është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësisë, ka të drejtën të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga byroja",* me par. 4 të këtij neni është paraparë *"byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat".*

Me dispozitën e nenit 960 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nr. 04/L-077 është paraparë që "*Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin*".

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Nga provat e administruara dhe në bazë të fakteve të kësaj çështje juridike, gjykata ka vërtetuar se me datë 30.03.2015 rreth orës 16:50 min në Prizren, është shkaktuar aksidenti trafiku nga automjeti Esoace Renault, me targa të regjistrimit .... të cilin e drejtonte G.(I) S. e i cili nga pakujdesia i shkakton dëme materiale të dëmtuarit K.D. Saktësisht vetura "B" VW-Passat (i dëmtuari) ishte duke qarkulluar në drejtim të qytetit dhe me të arritur përballë Tregut "Fatoni", para një depo mielli është goditur nga vetura "A" sepse e njëjta pa e siguruar kyçjen kishte ndërmarrë veprime të pa siguruara me automjet ku si pasoje e këtij veprimi ishte shkaktuar aksidenti. Në momentin e aksidentit automjeti i të padituri (si shkaktar i aksidentit) kishte qenë pa mbulesë siguruese, për këtë arsye paditësja e ka kompensuar të dëmtuarin K.D. për dëmin material të shkaktuar nga i padituri në shumë prej 553.00 (pesëqind e pesëdhjetë e tre) Euro.

Si rrjedhojë, i padituri G. (I) S. si shkaktar i aksidentit, bazuar në ligjin për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, për automjetet e pasiguruara, për dëmin e shkaktuar të dëmtuarit, ka për obligim që të njëjtën shumë t'ia rimbursojë këtu paditëses. Andaj, bazuar në këto fakte, Gjykata ka konstatuar se në rastin konkret i padituri duhet të obligohet që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit t'i paguajë shumën prej 553.00 Euro. Lartësia e rimbursimit që i padituri detyrohet tia paguaj paditëses është e barasvlefshme me shumën që paditësja ia ka kompensuar të dëmtuarit në aksident dhe kjo u vërtetua nga transferi bankar bërë nga paditësja Byroja Kosovare e Sigurimit dhe ujdia jashtëgjyqësore (të cilat gjinden në shkresat e lëndës). Nga dispozitat e lartcekura, e duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar, Gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për regresin e dëmit paditëses, pasi që paditësja i'a ka kompensuar të dëmtuarit dëmin e shkaktuar nga ana e të padituri. Andaj, nga të lartcekurat, u vendos si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse dhe shkresat tjera, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv të bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën për dëmin material nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (23.03.2018), për shkak se paditësja i'a ka kompensuar dëmin të dëmtuarit, ndërsa këtu i padituri si përgjegjës për dëmin e shkaktuar nuk i ka kompensuar të njëjtat dëme paditëses.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale sipas pikës nën III të këtij aktgjykimi, është marrë konform nenit 449 dhe 452 par.*1* lidhur me nenin 463 par. 1 të *LPK*-së ashtu që e detyroi të padituri në të paditësit t'ia kompensoj shpenzimet procedurale në emër të taksës gjyqësore shumën prej 20.00 Euro.

Nga faktet dhe arsyet e cekura më lartë gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.413/18 më datë 01.02.2023

Bashkëpunëtore profesionale **Gjyqtarja**
Delvina Ajazaj **Njomëza Berisha**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.